



Kompania Rajonale e Ujësjetës

Regional Water Supply Company
Regionalna vodovodna kompanija

1. Përmbledhje e arritjeve të KRU Gjakova Sh. A. për vitin 2025

Rezultati financiar -Gjatë periudhës së vitit 2025 bazuar në draft Pasqyrat Financiare vërehet se KRU Gjakova ka performancë të mirë financiare .

Në vitin 2025 të hyrat kanë shënuar rritje krahasuar me vitin 2024, ndërsa shpenzimet operative gjithashtu janë më të larta krahasuar me vitin 2024, pasi kemi ngritje të shpenzimeve të energjisë elektrike si pasojë e rritjes së çmimit të energjisë.

Efiçienca operative – Gjatë vitit 2025 KRU Gjakova, ka operuar me fitim operativ prej 563,613.00 euro, krahasuar me vitin 2024, fitimi operativ është më i ulët si pasojë e rritjes së shpenzimeve të energjisë elektrike në vitin 2025 edhe pse të hyrat kanë shënuar rritje krahasuar me vitin 2024.

Përformanca teknike – Prodhimi i ujit Janar-Dhjetor është 16,211,843 m³, jemi në bilancin e paraparë me PB 2025. Gjatë vitit 2024 humbjet e ujit ishin 47.94%, ndërsa në fund të muajt Dhjetor 2025, humbjet i kemi 48.80% (49%), vërehet një rritje në vlerë prej 0.86% më shumë krahasuar me vitin paraprak, kjo ka ndodhur kryesisht për shkak të keqpërdorimeve të ujit dhe lidhjeve ilegale.

Qeverisja & kontrolli- Bordi Drejtorëve si organ mbikëqyrës bazuar në kompetencat ligjore të përcaktuara në Statut, dhe Ligj sigurohet që të ketë një menaxhim të drejtë, mbrojtjen e aseteve dhe funksionim të qëndrueshëm financiar në Kompani. Komisioni i Auditimit përmes raporteve të auditorit brendshëm kontrollon çështjet financiare, kontrollin operacional , kontrollin e pajtueshmërisë (ligjet , rregulloret) , menaxhimin e rrezikut.

Ristrukturimet- Ristrukturimi Kompanisë është përfunduar sipas Vendimit KNMU /02/2022 dhe Udhëzuesit të dërguara nga Ministria Ekonomisë.

Cilësia e shërbimit – Furnizimi me ujë në gjithë zonën e shërbimit ka qenë 24/7, ne përjashtim të muajt Gusht ku ne disa pjese me lartësi të madhe kemi pasur ndonjë reduktim të planifikuar. Mirëmbajtja e rrjetit ka qenë në nivelin e duhur. Cilësia e ujit shume e mirë sipas UA 10/21.

Investimet –

1. Investimet vetanake të realizuar gjatë vitit 2025, janë si në vijim:

- Rehabilitimi i ujësjetës për fshatrat Ratkoc dhe Bratotin, bashkëfinancim me Komunën e Rahovecit, Vlera totale financiare:**59,968.80€**.
- Ndërtimi i rrjetit dhe stacionit të pompave shtytëse për SPK në Qafë Morinë, Vlera totale financiare:**67,722.75**, bashkëfinancim me Policinë e Kosovës.
- Ndërtimi i gypit furnizues nga stacioni i pompave Pataqan i ulet deri te rezervuari Pataqan i Epërm, Vlera totale financiare:**108,446.58€**.
- Ndërtimi i rrjetit të ujësjetës në rr. Ymer Pula dhe në 4 fshatrat të komunës së Gjakovës, Vlera totale financiare:**113,535.64€**.
- Renovimi dhe izolimi i hyrjes tek depoja e kemikaleve ITUP. Vlera totale financiare:**6,272.30€**.
- Renovimi i objekteve administrative, Vlera totale financiare:**7,856.86€**.
- Sanimi i rrjetit të kanalizimit si rast emergjent për shkak të depërtimit të betonit në rrjetin e kanalizimit në rrugën Nëna Terezë, Vlera financiare:44,847.00€ +52,548.41€. Total: **97,395.41€**.

1.1. Investimet vetanake – në vazhdim 2026

- Dislokimi-Ndërrimi i ujëmatësësve shtëpiak dhe zgjerimi i rrjetit shpërndarës i ujësjellësit nga prona private në prona publike për fshatrat Lipovec, dhe Smaq 1. Vlera totale financiare: **44,616.58€**. - [Vazhdon 2026](#).
- Instalimi i ujëmatësve jashtë shtëpive të banimit dhe lokaleve në fshatin Karashengjergj. Vlera totale financiare: **32,821.00€**. - [Vazhdon 2026](#).
- Asfaltimi i pjesëve ku është dëmtuar asfalti me rastin e defekteve në teren, në tërë Njësit e KRU Gjakova. Vlera totale financiare: **26,600.00€**. - **Kontrata e nënshkruar me datë: 11.12.2026**- [Vazhdon 2026](#).
- Sanimi i rrjetit të kanalizimit nëpër rrugë të ndryshme, në gypat e dëmtuar dhe ndërtimin e pusetave. Vlera totale financiare: **56,485.00€**. – **Kontrata e nënshkruar me datë: 02.12.2026**- [Vazhdon 2026](#).

1.2. Investimet Jo-Infrastrukturore

Nga investimet vetanake në investimet jo-infrastrukturore, kemi vlerën financiare prej: **188,746.00 €** / këtu përfshihen: blerja e Minibusit, furnizime të ndryshme dhe pajisje të TI).

2. Investimet – Projektet Investive nga ME - të realizuar gjatë vitit 2025, janë si në vijim:

- Furnizimi me ujë të pijshëm për fshatrat Hoçë e Madhe, Zoqisht dhe Optrushë dhe zonën industriale të komunës së Rahovecit FAZA 1, Investimi është nga ME 500,000.00€, në bashkëfinancim me Komunën e Rahovecit 200,000.00€ dhe KRU Gjakova 219,234.84€ /**vlera totale: 919,234.84€**/ **i përfunduar**
- Ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit për fshatrat e Krushë e Madhe, Piranë, Zojcë, dhe Medvec FAZA 1. Investimi është nga ME 700,000.00€, në bashkëfinancim me Komunën e Prizrenit 300,000.00€ dhe KRU Gjakova 248,952.53€, /**vlera totale: 1,248,952.53€**/ - **i përfunduar**
- Gypi i furnizimit me ujë të pijshëm dhe rrjeti i ujësjellësit për vendbanimet Krushë e Madhe, Piranë, Zojz, Medvec dhe Mamushë- FAZA II, Projekti financohet nga ME, vlera financiare e projektit është: **433,214.26€** - **i përfunduar**
- Instalimi i ujësjellësit "Gjakova III" për fshatrat Lugbunar, Osek Hilë dhe Skivjan të Komunës së Gjakovës, Investimi është nga ME 200,000.00€, në bashkëfinancim me Komunën e Gjakovës 200,000.00€ dhe KRU Gjakova 184,277.25€, /**vlera totale: 584,277.25 €**/ - **vazhdon 2026**.
- Rehabilitimi i ujësjellësit për Dol, Lipovec, Gerqinë, Investimi është nga ME 300,000.00€, në bashkëfinancim me Komunën e Gjakovës 244,362.83€ dhe KRU Gjakova 78,459,20€, /**vlera totale: 622,822.03€**/ - **Me datë: 13.01.2026, OSHP e ka kthyer në favor të Kompanisë. Kontrata është nënshkruar me 20.01.2026 – Fillon në muajin Shkurt 2026.**

3. Investimet nga donatore KfW

Rehabilitimi i rrjetit të kanalizimit në Gjakovë Faza V-VI

- 1) Rehabilitimi i Rrjetit të Ujërave të Ndotura,
- 2) Furnizimi i Autocisternës për mirëmbajtje të Rrjetit të Ujërave të Ndotura,
- 3) Ndërtimi i Argjinatures për mbrojtjen e Impiantit për Trajtimin e Ujërave të Ndotura (ITUN) nga vërshimet e lumit Erenik

Investimi është grant i pakthyeshem nga Banka Gjermane për Zhvillim KfW.

Vlera financiare e kontraktuar: 4,191,238.42€.

4. Nevojat e Investimeve në zonën e shërbimit 2026-2028

- Projekti: Furnizimi me ujë të pijshëm për fshatrat Hoçë e Madhe, Zoqisht dhe Opterushë dhe zonën industriale të komunës së Rahovecit LOT -2, për të finalizuar projektin nevojiten edhe: **600,000.00€**. Me këtë Investim do furnizohen me ujë nga Liqeni i Radoniqit mbi 2000 banorë të këtyre fshatrave.
- Projekti: Renovimi i Objektit të pompave të Zhdrellës dhe furnizimi me pompa dhe pajisje përcjellëse elektrike. -Vlera e planifikuar financiare: **650,000,000€**. Me këtë Investim do mundësohet furnizimi me pompa në rast të paraqitjes së rrezikut me rastin e ramjes së nivelit të liqenit që veq ka filluar që 2 vite.
- Projekti: Ndërrimi i gypit të çelikut nga dalja e tunelit deri të stacioni i filtrave L=770m Ø 1100 mm dhe gypi nga tuneli L=860m, për filtra DN 700-1100mm - Vlera e planifikuar financiare: **750,000,000€**. Me këtë investim ulët shkallën e rrezikshmërisë për furnizim me ujë të mbi 150.000 banorëve në rast të paraqitjes së korrozionit apo ndonjë avarie tjetër në gypat ekzistues që janë mbi 40 vite.
- Vendosjen e Ujëmatësve smart jashtë pronave private në disa fshatra në zonën e shërbimit ku humbjet i kemi me të mëdha. Vlera e planifikuar financiare mbi: **1,210,000.00€**. Me këtë investim do ulen humbjet e ujit, zvogëlimi i shpenzimeve të energjisë elektrike, zvogëlimi i keqpërdorimeve dhe furnizim me ujë cilësor i mbi 19.500 banorëve.
- Furnizim dhe instalimi i paneleve solare në kulmet e ITUP dhe ITUN. Vlera e planifikuar financiare mbi: **500,000.00€**. Me këtë investim do arrijmë në zvogëlimin e shpenzimeve të energjisë elektrike, ku do ulen edhe shpenzimet operative.

Sfidat :

- Rritja e çmimit të rrymës,
- Rritja e çmimit të derivateve,
- Zvogëlimi i humbjeve të ujit;
- Identifikimi i keqpërdoruesve të ujit në zonën e shërbimit,

- Realizimi i Investimeve të planifikuara,
- Të angazhohemi në mbrojtjen dhe sigurinë e punëtorëve tanë, dhe kjo të jetë aktivitet qenësor në vazhdimësi,
- Të shtojmë kontrollin e shpenzimeve dhe të këmbëngulim për rritjen e të hyrave nga arkëtimi.